



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 i datës 26.09.2008, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kryetari i Komunës së Lipjanit, merr këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN, Procedurat Standarde të Operimit (PSO) të të hyrave komunale dhe menaxhimit të pasurive jo financiare kapitale dhe jo kapitale**, si pjesë përbërëse e Doracakut “Libri i Proceseve”, i cili aktualisht përmban proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalitë, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. **Këto procedura standarde të operimit do të shërbejnë si procedura të brendshme për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë, gjeodezia, lejet e ndërtimit, lejet e gjendjes civile, lejet, prona komunale, dhe si procedura të brendshme për evidentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me rregulla financiare.**

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga gjeodezia;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga lejet e ndërtimit;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga lejet e gjendjes civile;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga prona komunale;
- PSO për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare nën 1,000€; dhe
- PSO për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare kapitale mbi 1,000€.

III. Për zbatimin e këtij aneks vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Administratës dhe Zyrtarët publik kompetent të Komunës.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Drejtorët e drejtorive të Komunës
- Zyrtarët kompetent të Komunës
- Arkivi i Komunës

INr. 1-404-4538
Lipjan, më 10.08.2021

Kryetari i Komunës
Imri Ahmeti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit
Opština Lipjan
Municipality of Lipjan

**PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT
PËR
REGJISTRIMIN DHE RAPORTIMIN E TË
HYRAVE KOMUNALE
NGA
TATIMI NË PRONË**

Gusht, 2021









PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
LEGJENDA/PËRSHKRIMI	4
1. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale: Të dhënat e përgjithshme për procesin	6
2. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga tatimi në pronë: Procedurat Standarde të Operimit	8
3. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga tatimi në pronë: Paraqitja e procesit përmes diagrameve	16

SHKURTESAT

DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF	Ministria e Financave
OE	Operatori Ekonomik
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHQ	Qendra për Shërbime me Qytetarë
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
DKA	Drejtorja Komunale e Arsimit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Th	Thesari
DTP	Departamenti i Tatimit në Pronë
NjTP	Njësia e Tatimit në Pronë
BQK	Banka Qëndrore e Kosovës

LEGJENDA/PËRSHKRIMI



Qëllimi

Ky dokument (tutje procesi) përshkruan Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave nga tatimi në pronë. Procesi i përshkruar më poshtë mbështetet në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale dhe praktikrat e mira gjerësisht të pranuar. Procesi përshkruan hapat në formë përshkruese (narrative) dhe me diagrame që duhet ndjekur gjatë regjistrimit dhe raportimit të të hyrave nga Tatimi në Pronë.

Përdorimi

Procedura Standarde e Operimit (PSO) është një dokument “që frymon” i cili duhet të rishikohet në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare për regjistrimin e të hyrave komunale. Ndryshimet si dhe versioni i përditësuar i PSO duhet t’u komunikohet të gjithë stafit që ndikohen direkt apo indirekt nga kjo PSO dhe palëve të tjera të interesit në komunë.

Kjo PSO gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e PSO-së gjithashtu i ndihmon stafit ekzistues dhe të ri në mbarëvajtjen e detyrave të tyre.

1. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PROCESIN

Titulli i procesit:	Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të të Hyrave nga Tatimi në Pronë
Organizata Buxhetore:	Komuna e Lipjanit
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin e Procedurave Standarde të Operimit për regjistrimin dhe raportin e të Hyrave nga Tatimin në Pronë.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Drejtoria për Buxhet dhe Financa/Njësia e Tatimit në Pronë
Versioni:	V-01/2021
Baza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale 2. Ligji Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal 3. Ligji për dhënien në shfrytëzim të dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 4. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar). 5. Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme 6. Ligji vjetor i Buxhetit 7. Rregulla Financiare 03/2010 për Të Hyrat (e rishikuar) 8. Vendim Komunal për Tatimin në Pronë 9. Procedura e MFK-së Nr. 7 Të Hyrat 10. Marrëveshjet e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Komunës për të hyrat vetanake.
Pronari i Procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës
Palët kryesore të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar 2. Njësia e Tatimit në Pronë në Komunë 3. Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministri të Financave 4. Zyrtari kryesor i të hyrave në komunë 5. Personi tatimpagues/debitori 6. Komisioni i ankesave 7. Banka Qendrore e Kosovës
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SIMFK) 2. Sistemi Informativ i Tatimit në Pronë (SITP) 3. Intraneti i Komunës
Dokumentet/dëshmitë kryesore që gjenerohen gjatë procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vendim Komunal për Tatimin në Pronë 2. Planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë 3. Fatura e tatimit në pronë 4. Çertifikata e vlerës së shtuar 5. Specifikimi i borxheve 6. Raporti i të hyrave ditore nga BQK-ja 7. Plani mujor i alokimeve 8. Kërkesë për ankimim të faturës së tatimit në pronë

	<ul style="list-style-type: none"> 9. Dokumenti i barazimit të të hyrave (specifikacioni) 10. Dokumentet përcjellësve të pagesave 11. Raporti i pranimit të mallit në SIMFK 12. Urdhër Obligimi për Pagesë 13. Urdhër blerja 14. Zotimi etj. 15. Raportet periodike financiare 16. Pasqyrat Vjetore Financiare
Ndërlidhja:	Procesin e Shpenzimeve
Numri i fazave:	17

2. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TATIMI NË PRONË: PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT

Procesi i regjistrimit dhe Raportimit të të hyrave nga Tatimi në Pronë						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Caktimi i Tarifave Vjetore	<p>1.1 Në baza vjetore Kuvendi Komunal cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave me përjashtim të kategorisë së pronës publike. Kufijtë e shkallëve tatimore janë të përcaktuar ndërmjet 0.15% dhe 1%</p> <p>1.2 Nëse Kuvendi Komunal nuk përcakton në kohë normën tatimore, Ministria e Financave aplikon normën e fundit tatimore të përcaktuar nga kuvendi komunal për atë kategori përkatëse</p> <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px; margin-top: 10px;"> <p>Nga tatimi janë të liruar institucionet publike, organizatat e kombeve të bashkuara, organet e saj dhe misionet e specializuara të OKB, bashkimi evropian ose organet e tij, forcat shumëkombëshe të Kosovës, konsullatat, ambasadat e akredituara, OJQ-të me status të përfitimit publik dhe institucionet fetare.</p> </div>	<p>1. Kuvendi Komunal i Komunës</p> <p>2. Ministria e Financave</p>	Çdo vit deri më 30 nëntor të vitit para vendosjes së tatimit	<p>1. Vendim Komunal i Tatimit në Pronë</p>	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p> <p>3. Vendim vjetor komunale për tatimin mbi pronën e paluajtshme</p>
2.	Planifikimi i të hyrave nga Tatimi në Pronë	2.1 Zyrtari Kryesor Financiar në bashkëpunim me udhëheqësin e Njesisë së Tatimit në Pronë dhe drejtoritë përkatëse bën planifikimin e të hyrave nga tatimi në pronë	<p>1. Zyrtari Kryesor Financiar</p> <p>2. Udhëheqësi i Njesisë së</p>	Çdo vit	1. Planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë	n/a

			Tatimit në Pronë			
3.	Regjistrimi dhe Administrimi i të dhënave në Regjistrin e Tatimit në Pronë	<p>3.1 Komuna është përgjegjëse për</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Regjistrimin, menaxhimin e të dhënave për tatimin në pronë në regjistrat e tatimit në pronë. b. Klasifikimin e pronave të paluajtshme c. Inspekton pronat e paluajtshme d. Bashkëpunon me Ministrinë e Financave në vlerësimin e pronave të paluajtshme 	<p>1.Njësia e Tatimit në Pronë</p> <p>2. Ministria e Financave/Departamenti i Tatimit në Pronë</p>	Në vijimësi	Nuk ka	1.Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
4.	Gjenerimi i Faturave të tatimit në pronë	<p>4.1 Komuna përdor sistemin qendror të tatimit në pronë të Ministrisë së Financave për lëshimin e faturës së tatimit në pronë.</p> <p>4.2 Njësia e Tatimit në Pronë lëshon fatura vjetore të tatimit në pronë.</p> <p>4.3 Fatura vjetore e tatimit në pronë nuk lëshohet nëse shuma totale e detyrimeve tatimore nuk kalon shumën prej tre (3) Euro.</p>	1.Njësia e Tatimit në Pronë	<p>Jo më vonë se 31 janari i çdo viti tatimor.</p> <p>Afati mund të zgjatet me kërkesë dhe aprovim nga MF por jo më vonë se 31 mars të të njëjtit vit tatimor.</p>	<p>1.Fatura</p> <p>2.Certifikata e vlerës së shtuar</p> <p>3.Specifikimi i borxheve</p>	1.Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
5.	Njoftimi (Shpërndarja) e Faturave	5.1 Brenda dhjetë (10) ditëve pune pas datës së lëshimit të faturave të tatimit në pronë, komuna dërgon faturën e tatimit dhe certifikatën e vlerës së shtuar të të gjithë	1.Njësia e Tatimit në Pronë	1. Dhjetë (10) ditë pune dërgimi i faturës	1.Fatura e tatimit në pronë	1.Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

		<p>personat e identifikuar si tatimpagues ose debitor në regjistrat e tatimit në pronë.</p> <p>5.2 Njësia e Tatimit në Pronë brenda dhjetë (10) dhjetë ditëve pune pas datës së lëshimit të faturave të tatimit në pronë, shpall dhe publikon një njoftim për të informuar tatimpaguesit.</p> <p>5.3 Shpërndarja e faturave mund të bëhet qoftë përmes punonjësve komunal ose përmes postës.</p> <p>5.4 Personat të cilët brenda tridhjetë (30) ditëve nuk e kanë marrë faturën e tatimit në pronë, kanë të drejtë të marrin një kopje të vërtetuar të faturës duke u paraqitur fizikisht apo përmes përfaqësuese të tyre të autorizuar.</p>		<p>2.Dhjetë (10) ditë pune shpallja dhe njoftimi</p> <p>3. Tridhjetë (30) ditë pune tatimpaguesi t marrin faturën fizikisht</p>	<p>2.Certifikata e vlerës së shtuar</p> <p>3.Specifikimi i borxheve</p> <p>4. Njoftimi informues për tatimpagues</p>	<p>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</p> <p>2.Rregullore vjetore komunale për tatimin mbi pronën e paluajtshme</p>
6.	Pagesa e Faturave të Tatimit në Pronë	<p>6.1 Tatimpaguesit paguajnë detyrimet tatimore me dy këste të barabarta, deri më 30 prill dhe 30 shtator të vitit tatimor ose si një pagesë të vetme.</p> <p>6.2 Pagesa e tatimit në pronë bëhet në EURO dhe në ndonjërin nga bankat komerciale apo institucionet e pagesave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës</p> <p>6.3 Kur dita e fundit për pagesën e detyrimeve tatimore bie në ditë pushimi, data e pagesës është dita e parë e punës pas ditës së pushimit.</p> <p>6.4 Komuna mundet, në rrethana të veçanta të bëj shtyrjen e afatit për pagesën e</p>	<p>1.Tatimpaguesit</p> <p>2.Njësia e Tatimit në Pronë</p>	<p>1.Kësti i parë deri më 30 Prill</p> <p>2.Kësti i dytë deri më 30 shtator të vitit tatimor</p>	<p>1.Fatura e tatimit në pronë</p> <p>2.Certifikata e vlerës së shtuar</p> <p>3.Specifikimi i borxheve</p>	<p>1.Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme</p> <p>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës</p> <p>2. Vendim vjetor komunal për tatimin mbi pronën e paluajtshme</p>

		detyrimeve tatimore. Pas kërkesës, shtyrja mund të bëhet për një faturë specifike që shërben si vendbanim parësor i personit dhe është i kufizuar jo më shumë se dy (2) vjet nda data e pranimit të kërkesës.				
7.	Raportimi i të hyrave nga Banka Qendrore e Kosovës për Thesarin	7.1 Banka Qendrore e Kosovës në baza ditore i dërgon Thesarit raport për të hyrat e asaj date	1.Banka Qendrore e Kosovës	Çdo ditë	1.Raporti i të hyrave ditore	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
8.	Regjistrimi i të hyrave	8.1 Thesari bazuar në raportin ditor të BQK-së, bën kategorizimin e të hyrave për komunën përkatëse në raporte te specifikuara ditore.	1.Thesari i Ministrisë së Financave	Çdo ditë	Nuk ka	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
9.	Kategorizimi/regjistrimi i të hyrave nga komuna ne SIMFK	9.1 Zyrtari kryesor i të hyrave bazuar në ekstraktin ditor të të hyrave të dërguar nga Thesari, bën regjistrimin/shpërndarjen e të hyrave në kategoritë kryesore të të hyrave në SIMFK përfshirë edhe regjistrimin e të hyrave nga tatimi në pronë.	1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave në Komunë	Çdo ditë	1.Ekstrakt ditor të të hyrave	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).


10.	Barazimi	10.1 Zyrtaari Kryesor i të Hyrave njofton Njësinë e Tatimit në Pronë për të hyrat e përgjithme për atë datë.	1.Zyrtaari Kryesor i të Hyrave 2.Njësia e Tatimit në Pronë	Çdo ditë	1.Njoftim me e-mail	n/a
11.	Shlyerja e detyrimeve tatimore nga Departamenti i Tatimit në Pronë	11.1 Departamenti i Tatimit në Pronë bën shlyerjen e detyrimeve tatimore në bazë të raporteve të inkasimit të të hyrave komunale të pranuar nga Thesari.	1.Departamenti i Tatimit në Pronë	Çdo ditë	SITP	n/a
12.	Alokimi i të hyrave	11.1 Zyrtaari Kryesor Financiar i Komunës bën alokimin e rregullt të të hyrave të cilat bëhen të disponueshme për shpenzim	1.Zyrtaari Kryesor Financiar	Çdo muaj ose më shpeshë	1.Plani mujor i alokimeve	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2.Rregullore Nr.02/2017 për Alokimin e Fondeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .


13.	Shpenzimi i të hyrave	12.1 Të hyrat shpenzohen në kategoritë përkatëse [shih më detajisht procesin e shpenzimeve nga libri i proceseve]	1.Drejtoritë përkatëse	Nuk ka	1.Dokumentet pagesave • Raporti i pranimit të mallit në SIMFK • Urdhër Obligimi për Pagesë • Urdhër blerja • Zotimi.	1.Rregllore Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2.Libri i Proceseve
14.	Raportimi në Pasqyra Vjetore Financiare	13.1 Zyrtari Kryesore Financiar bën raportimin e të hyrave nga SIMFK në Pasqyra Vjetore Financiare sipas kërkesës dhe në fundvit.	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Raportimet periodike financiare 2.Raportimi vjetor në PVF	1.Raportet Financiare 2.Pasqyrat Vjetore Financiare	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2.Rregullore Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

Nën-Procesi: Ankimimi dhe Rimbursimi i Tatimpaguesit						
15.	Ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë	<p>14.1 Personi tatimpagues i cili konsideron në mënyrë të arsyeshme fatura e tatimit në pronë është e pasaktë, mund të ushtrojë ankesë dhe të kërkojë rishqyrtim plotësisht ose të pjesërisht të faturës së tatimit nga komuna</p> <p>14.2 Ankesa pranohet në Qendrën për Shërbime ndaj Qytetarëve, e cila i drejtohet Njesisë së Tatimit në Pronë së bashku me dokumentacionin mbështetës jo më vonë se dy (2) muaj nga dita e fundit për lëshimin e faturës së tatimit në pronë për atë vit tatimor. Ankesa nuk e pezullon detyrimin për të paguar detyrimet tatimore.</p> <p>14.3 Komuna shqyrton dhe merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Afati mund të shtyhet edhe për tridhjetë (30) ditë për shqyrtim të ankesës me një vendim të arsyetuar.</p>	<p>1. Tatimpaguesi/debitori</p> <p>2. Njësia e Tatimit në Pronë</p>	<p>1. Dy (2) muaj për ankesë</p> <p>2. Gjashtëdhjetë (60) ditë për përgjigje</p> <p>3. Tridhjetë (30) ditë shtesë</p>		<p>1. Rregulla 02/2013 për raportimin e obligimeve të paguara të organizatave buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
16.	Ri-ankimimi ndaj vendimit të komunës	15.1 Personi tatimpagues/debitori mund të ankimojë vendimin e komunës në Ministrinë e Financave brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga pranimi i ankesës dhe i dërgon personit vendimin brenda 5 ditëve pune pas datës së marrjes së vendimit.	<p>1. Tatimpaguesi/debitori</p> <p>2. Ministria e Financave</p>	<p>1. Tridhjetë ditë kalendarike (30) për ankimim</p> <p>2. Pesë (5) ditë për</p>	<p>1. Kërkesë për ankimim</p> <p>2. Vendim për ankesën</p>	<p>1. Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>

		<p>15.2 Ministria e Financave merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda dyzet e pesë (45) ditëve kalendarike nga data e pranimit të ankesës.</p> <p>15.3 Personi i cili nuk pajtohet me vendimin mbi ankesën e marrë nga Ministria e Financave mund të ushtrojë padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike.</p>		<p>dërgim të vendimit</p> <p>3. Dyzet e pesë (45) ditë kalendarike MF</p> <p>4. Tridhjetë (30) ditë kalendarike për padi në Gjykatë.</p>		
17.	Rimbursimi i tatimpaguesit/debitorit	<p>16.1 Nëse vendimi apo aktgjykimi i marrë është në favor të tatimpaguesit ose debitorit, çdo detyrim tatimor i paguar më tepër nga tatimpaguesi ose debitori dhe interesi i llogaritur nga data e pagesës i rimbursohen tatimpaguesit ose debitorit brenda nëntëdhjetë (90) ditëve kalendarike nga data e vendimit final.</p>	<p>1. Njësia e Tatimit në Pronë</p> <p>2. Zyrtari Kryesor Financiar</p>	<p>1. Nëntëdhjetë (90) ditë kalendarike</p>	Nuk ka	<p>1. Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës)</p>
Fundi i procesit						

3. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TATIMI NË PRONË: PARAQITJA E PROCESIT PËRMES DIAGRAMEVE







Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit
Opština Lipljan
Municipality of Lipjan

PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT PËR REGJISTRIMIN DHE RAPORTIMIN E TË HYRAVE KOMUNALE NGA GJEODEZIA

Gusht, 2021









PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
LEGJENDA/PËRSHKRIMI	4
1. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga gjeodezia: Të dhënat e përgjithshme për procesin	6
2. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga të hyrat nga gjeodezia: Procedurat Standarde të Operimit	8
3. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga gjeodezia: Paraqitja e procesit përmes diagrameve	13

SHKURTESAT

DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF	Ministria e Financave
OE	Operatori Ekonomik
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHQ	Qendra për Shërbime me Qytetarë
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Th	Thesari

LEGJENDA/PËRSHKRIMI



Qëllimi

Ky dokument (tutje procesi) përshkruan Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për regjistrimin dhe raportimin e të të hyrave komunale nga gjeodezia. Procesi i përshkruar më poshtë mbështetet në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale dhe praktikrat e mira gjerësisht të pranuar. Procesi përshkruan hapat në formë përshkruese (narrative) dhe me diagrame që duhet ndjekur gjatë regjistrimit dhe raportimit të të hyrave nga gjeodezia.

Përdorimi

Procedura Standarde e Operimit (PSO) është një dokument “që frymon” i cili duhet të rishikohet në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare për regjistrimin e të hyrave komunale. Ndryshimet si dhe versioni i përditësuar i PSO duhet t’u komunikohet të gjithë stafit që ndikohen direkt apo indirekt nga kjo PSO dhe palëve të tjera të interesit në komunë.

Kjo PSO gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e PSO-së gjithashtu i ndihmon stafit ekzistues dhe të ri në mbarëvajtjen e detyrave të tyre.

1. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA GJEODEZIA: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PROCESIN

Titulli i procesit:	Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të të Hyrave nga Gjeodezia
Organizata Buxhetore:	Komuna e Lipjanit
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin e Procedurave Standarde të Operimit për regjistrimin dhe raportin e të Hyrave Komunale nga Gjeodezia.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Versioni:	V-01/2021
Baza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale 2. Ligji Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal 3. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar). 4. Ligji vjetor i Buxhetit 5. Rregulla Financiare 03/2010 për Të Hyrat (e rishikuar) 6. Udhëzimi Administrativ 08/2020 dhe 12/2019 Agjencioni Katastral i Kosovës 7. Procedura e MFK-së Nr. 7 Të Hyrat 8. Marrëveshjet e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Komunës për të hyrat vetanake. 9. Udhëzimi Administrativ 08/2020 Agjencioni Katastral i Kosovës 10. Udhëzimi Administrativ 12/2019 nga Agjencioni Katastral i Kosovës
Pronari i Procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës
Palët kryesore të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtares Kryesor Financiar Komunal 2. Drejtorja e Katastrit dhe Pronës 3. Zyrtares kryesor i të hyrave në komunë 4. Zyrtares përgjegjës për pranim të faturave/protokollim 5. Zyrtares përgjegjës administrativ/financiar 6. Zyrtares përgjegjës për shërbime me qytetarë 7. Banka Qendrore e Kosovës 8. Personi fizik ose juridik
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SIMFK) 2. Intraneti i Komunës
Dokumentet/dëshmitë kryesore që gjenerohen gjatë procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kontrata për shitblerje 2. Planifikimi i të hyrave nga gjeodezia 3. Fatura për pagesë (UNIREF) 4. Dëshmi për pranim të faturës (kopje) 5. Raporti i të hyrave ditore nga BQK-ja 6. Dokumenti i barazimit të të hyrave (specifikacioni) 7. Dokumentet përcjellësve të pagesave <ul style="list-style-type: none"> • Raporti i pranimet të mallit në SIMFK • Urdhër Obligimi për Pagesë

	<ul style="list-style-type: none"> • Urdhër blerja • Zotimi etj. <p>8. Plani mujor i alokimeve 9. Raportet periodike financiare 10. Pasqyrat Vjetore Financiare</p>
Ndërlidhja:	Procesin e Shpenzimeve
Numri i fazave:	11

2. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TË HYRAT NGA GJEODEZIA: PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT

Procesi i regjistrimit dhe Raportimi të të hyrave nga Gjeodezia						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Planifikimi i të hyrave nga Gjeodezia	1.1 Zyrtari Kryesor Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit, Gjeodezi dhe Kataster bën planifikimin e të hyrave nga gjeodezia	1.Zyrtari Kryesor Financiar 2. Udhëheqësi i Drejtorisë së Urbanizmit, Gjeodezi dhe Kataster	Çdo vit	1.Planifikimi i të hyrave nga gjeodezia	n/a
2.	Kontrata e shitblerjes ndërmjet palëve	2.1 Personat fizik apo juridik, lidhin kontratë për shit-blerje të pronës.	1.Personat fizik ose juridik	Nuk ka	1.Kontrata për shitblerje	n/a
3.	Kalkulimi i taksës për pagesë dhe gjenerimi i faturës	3.1 Zyrtari përgjegjës në drejtorinë e Urbanizmit, Gjeodezise dhe Katastres, bazuar në shumën e transaksionit të kontratës së noterizuar ndërmjet palëve, dhe kufijve të caktuar nga rregullorja komunale për caktimin e taksës, përcakton shumën për pagesë. 3.2 Zyrtari përgjegjës në drejtorinë e Urbanizmit, Gjeodezise dhe Katastres në intranetin e komunës fut të dhënat e personit juridik/fizik dhe gjeneron faturën (UNIREF) me shumën përkatëse.	1.Zyrtari përgjegjës në Drejtorinë e Pronës dhe Katastrit	Nuk ka	1.Fatura	1.Udhëzimi Administrativ 08/2020 dhe 12/2019 Agjencioni Katastral i Kosovës

		3.3 Nëse prona regjistrohet në bashkëpronësi nga burri dhe gruaja, bazuar në rregulloren për caktimin e tarifave, lirohen nga pagesa e kësaj takse.				
4.	Pagesa e Faturës	4.1 Fatura merret dhe paguhet nga personi apo subjekti juridik dhe pagesa bëhet në EUR në ndonjërin nga bankat apo institucionet e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. 4.2 Personi apo subjekti juridik e sjell një kopje të dëshmisë së pagesës tek zyrtari i drejtorisë së gjeodezisë.	1.Personi fizik ose subjekti juridik	1.Menjëherë	1.Kopje dëshmisë së pagesës	1.Rregllore Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2.Libri i Proceseve
5.	Raportimi i të hyrave nga Banka Qendrore e Kosovës për Thesarin	5.1 Banka Qendrore e Kosovës në baza ditore i dërgon Thesarit raport për të hyrat e datës.	1.Banka Qendrore e Kosovës	1. Çdo ditë	1.Ekstrakt i të hyrave	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
6.	Regjistrimi i të hyrave	6.1 Thesari bazuar në raportin ditore të BQK-së, bën kategorizimin e të hyrave për komunën përkatëse në raporte te specifikuara ditore. 6.2	1.Thesari i Ministrisë së Financave	1. Çdo ditë	Nuk ka	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).


7.	Kategorizimi/regjistrimi i të hyrave nga komuna ne SIMFK	<p>7.1 Zyrtari kryesor i të hyrave bazuar në ekstraktin ditor të të hyrave të dërguar nga Thesari, bën regjistrimin/shpërndarjen e të hyrave në kategoritë kryesore të të hyrave në SIMFK përfshirë edhe regjistrimin e të hyrave nga gjeodezia.</p> <p>7.2 Zyrtari Kryesor i të Hyrave njofton Drejtorinë Përkatëse për të hyrat totale për atë datë.</p>	1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave	Çdo ditë	Nuk ka	<p>1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
8.	Barazimi i të hyrave	<p>8.1 Zyrtari Kryesor i të Hyrave në baza të rregullta bën barazimin me drejtorinë përkatëse. <i>[barazimi duhet të bëhet çdo muaj, mirëpo varësisht prej volumit dhe nevojës, barazimi mund të bëhet edhe më shpesh mirëpo së pak një herë në muaj]</i></p> <p>8.2 Zyrtari i dejtorisë përkatëse takohet me zyrtarin e të hyrave dhe bëjnë barazimin e të hyrave në bazë të dëshmimeve që kanë</p> <p>8.3 Nëse të hyrat barazohen, atëherë të dy palët e nënshkruajnë një spcifikacion që është bërë barazimi i të hyrave ku ceket muaj, data, lloj të hyrave dhe drejtoria.</p> <p>8.4 Nëse të hyrat nuk barazohet, atëherë diferenca hetohet nga zyrtari i drejtorisë përkatëse dhe zyrtari i të hyrave</p>	<p>1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave</p> <p>2.Zyrtari përgjegjës në drejtorinë përkatëse</p>	1.Çdo muaj	1. Dokumenti i barazimit të të hyrave i nënshkruar (specifikacioni)	n/a
9.	Alokimi i të hyrave	9.1 Zyrtari Kryesor Financiar i Komunës bën alokimin e rrgullt të të hyrave të cilat bëhen të disponueshme për shpenzim	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Çdo muaj	1.Plani mujor i alokimeve	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë


						<p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Rregullore Nr.02/2017 për Alokimin e Fondeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
10.	Shpenzimi i të hyrave	10.1 Të hyrat shpenzohen në kategoritë përkatëse [shih më detajisht procesin e shpenzimeve nga libri i proceseve]	1.Zyrtari Kryesor Financiar	Nuk ka	<p>1.Dokumentet pagesave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raporti i pranimit të mallit në SIMFK • Urdhër Obligimi për Pagesë • Urdhër blerja • Zotimi. 	<p>1.Rregllore Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Libri i Proceseve</p>
11.	Raportimi në Pasqyra Vjetore Financiare dhe raportimi i	11.1 Zyrtari Kryesor Financiar bën raportimin e të hyrave nga SIMFK në Pasqyra Vjetore Financiare në fundvit dhe raportet e rregullta financiare.	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Deri me 31 Janar të vitit pasues	1.Pasqyrat Vjetore Financiare	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

	rregullt financiar				2. Raportimet e rregullta financiare	(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2.Rregullore Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatrat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
Fundi i procesit						

3. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA GJEODEZIA: PARAQITJA E PROCESIT PËRMES DIAGRAMEVE

Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të të Hyrave nga Gjeodezia dhe Katastri







Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit
Opština Lipjan
Municipality of Lipjan

**PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT
PËR
REGJISTRIMIN DHE RAPORTIMIN E TË
HYRAVE KOMUNALE
NGA
LEJET E NDËRTIMIT**

Gusht, 2021









PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
LEGJENDA/PËRSHKRIMI	4
1. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të hyrave komunale: Të dhënat e përgjithshme për procesin	6
2. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga të hyrat nga lejet e ndërtimit: Procedurat Standarde të Operimit	8
3. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga lejet e ndërtimit: Paraqitja e procesit përmes diagrameve	14

SHKURTESAT

DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF	Ministria e Financave
OE	Operatori Ekonomik
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHQ	Qendra për Shërbime me Qytetarë
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Th	Thesari

LEGJENDA/PËRSHKRIMI



Qëllimi

Ky dokument (tutje procesi) përshkruan Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave nga Lejet e Ndërtimit. Procesi i përshkruar më poshtë mbështetet në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale dhe praktikrat e mira gjerësisht të pranuar. Procesi përshkruan hapat në formë përshkruese (narrative) dhe me diagrame që duhet ndjekur gjatë regjistrimit dhe raportimit të të hyrave nga Lejet e Ndërtimit.

Përdorimi

Procedura Standarde e Operimit (PSO) është një dokument “që frymon” i cili duhet të rishikohet në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare për regjistrimin e të hyrave komunale. Ndryshimet si dhe versioni i përditësuar i PSO duhet t’u komunikohet të gjithë stafit që ndikohen direkt apo indirekt nga kjo PSO dhe palëve të tjera të interesit në komunë.

Kjo PSO gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e PSO-së gjithashtu i ndihmon stafit ekzistues dhe të ri në mbarëvajtjen e detyrave të tyre.

1. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË HYRAVE KOMUNALE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PROCESIN

Titulli i procesit:	Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të të Hyrave Komunale
Organizata Buxhetore:	Komuna e Lipjanit
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin Procedurave Standarde të Operimit për regjistrimin dhe raportin e të Hyrave Komunale.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Versioni:	V-01/2021
Baza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale 2. Ligji Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal 3. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar). 4. Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim 5. Ligji vjetor i Buxhetit 6. Rregulla Financiare 03/2010 për Të Hyrat (e rishikuar) 7. Rregulloret Vjetore Komunale për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha 8. Procedura e MFK-së Nr. 7 Të Hyrat 9. Marrëveshjet e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Komunës për të hyrat vetanake.
Pronari i Procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës
Palët kryesore të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar Komunal 2. Drejtoria e Urbanizmit 3. Zyrtari kryesor i të hyrave në komunë 4. Zyrtari përgjegjës për shërbime me qytetarë 5. Operatori Ekonomik/ personi fizik/entitet tjetër juridik
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SIMFK) 2. Intraneti i Komunës
Dokumentet/dëshmitë kryesore që gjenerohen gjatë procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kërkesa për pajisje me kushtet ndërtimore 2. Kërkesa për pajisje me leje të ndërtimit <ul style="list-style-type: none"> • kopja e planit • kushtet ndërtimore • dokumentacioni ndërtimor • ndikimi në mjedis 3. Fatura dhe/ose kërkesa për pagim 4. Dëshmi për pranim të faturës (kopje) 5. Dokumentet përcjellësve të pagesave <ol style="list-style-type: none"> a. Raporti i pranimi të mallit në SIMFK b. Urdhër Obligimi për Pagesë c. Urdhër blerja d. Zotimi etj. 6. Plani mujor i alokimeve

	7. Raportet periodike financiare 8. Pasqyrat Vjetore Financiare
Ndërlidhja:	Procesi i shpenzimeve
Numri i fazave:	13

2. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TË HYRAT NGA LEJET E NDËRTIMIT: PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT

Procesi i regjistrimit dhe Raportimi të të hyrave nga Lejet e Ndërtimit						
Hapat	Aktiviteti	Aktivetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Planifikimi i të hyrave nga Lejet e Ndërtimit	1.1 Zyrtari Kryesor Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit bën planifikimin e të hyrave nga lejet e ndërtimit	1.Zyrtari Kryesor Financiar 2. Udhëheqësi i Drejtorisë së Urbanizmit	Çdo vit	1.Planifikimi i të hyrave nga Urbanizmi	n/a
2.	Projekti i Ndërtimit	2.1 Personi fizik ose juridik duhet të ketë projektin ideor dhe konceptual të ndërtimit i cili i prezantohet drejtorisë së urbanizmit.	1.Personat fizik ose juridik	Nuk ka	1.Projekti ideor dhe konceptual 2. Matjet gjeodezike dhe gjendja fotografike në teren	1.Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
3.	Aplikimi për Kushtet Ndërtimore dhe Leje të Ndërtimit	3.1 Personi fizik ose juridik paraqet kërkesë pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë për pajisje me kushte ndërtimore (Kategoria I dhe II). 3.2 Personi fizik ose juridik paraqet kërkesë pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë për pajisje me leje të ndërtimit 3.3 Qendra për Shërbime me Qytetarë drejton kërkesën tek drejtorja e Urbanizmit	1.Personi fizik ose juridik	Nuk ka	1.Kërkesa për pajisje me leje ndërtimit dhe dokumentet përcjellëse - kopja e planit -kushtet ndërtimore	1.Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<p>Kategoria I – ndërtime me rrezikshmëri të ulët</p> <p>Kategoria II – ndërtime me rrezikshmëri të mesme</p> <p>Kategoria III – ndërtime me rrezikshmëri të lartë dhe interes nacioanal</p>			<p>- dokumentacioni ndërtimor</p> <p>-ndikimi në mjedis</p> <p>-Dokumentet e parces</p> <p>-Projekti kryesor</p> <p>-Elaborati i zjarrit, etj.</p>	
4.	Shqyrtimi i aplikacionit dhe nxjerrja e vendimit	<p>4.1 Drejtoria e Urbanizmit shqyrton projektin e ndërtimit dhe aplikacionin për pajisje me leje ndërtimore</p> <p>4.2 Drejtoria pas shqyrtimit të aplikacionit dhe projektit ndërtimor, lëshon vendim.</p>	1.Drejtoria e Urbanizmit	<p>1.Pesëmbëdhjetë (15) ditë për kushte ndërtimore</p> <p>2.Tridhjetë (30) ditë pune për leje ndërtimore</p>	1.Vendim për dhënie të lejes	<p>1.Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
5.	Kalkulimi i taksës për pagesë dhe gjenerimi i faturës	5.1 Zyrtari përgjegjës në drejtorinë e Urbanizmit, Ligjin për Ndërtim dhe bazuar në vendimin e drejtorisë, dhe rregullores së komunës për caktimin e tarifave të lejeve të ndërtimit, përcakton shumën për pagesë.	1.Zyrtari përgjegjës në Urbanizmit	Pas aprovimit të lejes	1.Fatura	<p>1.Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Rregullore komunale për</p>

		<p>5.2 Zyrtari përgjegjës në drejtorinë e Urbanizmit në intranetin e komunës vendos të dhënat e personit juridik/fizik dhe gjeneron faturën (Uniref) me shumën përkatëse.</p> <p>5.3 Personi fizik ose juridik, pajiset me faturën për pagesë.</p>				taksa dhe ngarkesa
6.	Pagesa e Faturës	<p>6.1 Fatura merret dhe paguhet nga personi apo subjekti juridik dhe pagesa bëhet në EUR në ndonjërin nga bankat apo institucionet e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.</p> <p>6.2 Personi apo subjekti juridik e sjell një kopje të dëshmisë së pagesës tek zyrtari i Drejtorisë së Urbanizmit.</p>	1. Personi fizik ose subjekti juridik	1. Menjëherë	1. Kopje dëshmisë së pagesës	
7.	Raportimi i të hyrave nga Banka Qendrore e Kosovës për Thesarin	7.1 Banka Qendrore e Kosovës në baza ditore i dërgon Thesarit raport për të hyrat e datës.	1. Banka Qendrore e Kosovës	1. Çdo ditë	1. Raport i të hyrave ditore	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
8.	Regjistrimi i të hyrave	<p>8.1 Thesari bazuar në raportin ditor të BQK-së, bën kategorizimin e të hyrave për komunën përkatëse në raporte të specifikuar ditore.</p> <p>8.2</p>	1. Thesari i Ministrisë së Financave	1. Çdo ditë	Nuk ka	1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë


						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
9.	Kategorizimi/regjistrimi i të hyrave nga komuna ne SIMFK	<p>9.1 Zyrtari kryesor i të hyrave bazuar në ekstraktin ditor të të hyrave të dërguar nga Thesari, bën regjistrimin/shpërndarjen e të hyrave në kategoritë kryesore të të hyrave në SIMFK përfshirë edhe regjistrimin e të hyrave nga lejet e ndërtimit.</p> <p>9.2 Zyrtari Kryesor i të Hyrave njofton Drejtorinë e Urbanizmit për të hyrat e totale për atë datë.</p>	1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave	Çdo ditë	1.Ekstrakt ditor të të hyrave	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
10.	Barazimi i të hyrave	<p>10.1 Zyrtari Kryesor i të Hyrave në baza të rregullta bën barazimin me drejtorinë përkatëse. <i>[barazimi duhet të bëhet çdo muaj, mirëpo varësisht prej volumit dhe nevojës, barazimi mund të bëhet edhe më shpesh mirëpo së pak një herë në muaj]</i></p> <p>10.2 Zyrtari i dejtorisë përkatëse takohet me zyrtarin e të hyrave dhe bëjnë barazimin e të hyrave në bazë të dëshmimeve që kanë</p> <p>10.3 Nëse të hyrat barazohen, atëherë të dy palët e nënshkruajnë një spcifikacion që është bërë barazimi i të hyrave ku ceket muaj, data, lloj të hyrave dhe drejtoria.</p> <p>10.4 Nëse të hyrat nuk barazohet, atëherë diferenca hetohet nga zyrtari i drejtorisë përkatëse dhe zyrtari i të hyrave</p>	<p>1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave</p> <p>2.Zyrtari përgjegjës në drejtorinë përkatëse</p>	1.Çdo muaj	1. Dokumenti i barazimit të të hyrave i nënshkruar (specifikacioni)	n/a


11.	Alokimi i të hyrave	11.1 Zyrtari Kryesor Financiar i Komunës bën alokimin e rregullt të të hyrave të cilat bëhen të disponueshme për shpenzim	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Çdo muaj/sipas nevojës me shpesh	1.Plani mujor i alokimeve	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2.Rregullore Nr.02/2017 për Alokimin e Fondeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
12.	Shpenzimi i të hyrave	12.1 Të hyrat shpenzohen në kategoritë përkatëse [shih më detajisht procesin e shpenzimeve nga libri i proceseve]	1.Zyrtari Kryesor Financiar	Nuk ka	1.Dokumentet pagesave Raporti i pranimt të mallit në SIMFK Urdhër Obligimi për Pagesë Urdhër blerja Zotimi	1.Rregullore Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2.Libri i Proceseve

13.	Raportimi në Pasqyra Vjetore Financiare dhe raportimi i rregullt financiar	13.1 Zyrtari Kryesor Financiar bën raportimin e të hyrave nga SIMFK në Pasqyra Vjetore Financiare në fundvit dhe raportet e rregullta financiare.	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Raportimet periodike financiare 2.Raportimi vjetor në PVF	1.Raportet Financiare 2.Pasqyrat Vjetore Financiare	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2.Rregullore Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
Fundi i procesit						

3. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA LEJET E NDËRTIMIT: PARAQITJA E PROCESIT PËRMES DIAGRAMEVE

Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të të Hyrave nga Lejet e Ndërtimit







Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit
Opština Lipljan
Municipality of Lipjan

**PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT
PËR
REGJISTRIMIN DHE RAPORTIMIN E TË
HYRAVE KOMUNALE NGA
DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE**

Gusht, 2021









PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
LEGJENDA/PËRSHKRIMI	4
1. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të hyrave nga dokumentet e gjendjes civile: Të dhënat e përgjithshme për procesin	6
2. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga të hyrat nga dokumentet e gjendjes civile: Procedurat Standarde të Operimit	8
3. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga të hyrat nga dokumentet e gjendjes civile: Paraqitja e procesit përmes diagrameve	16

SHKURTESAT

DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF	Ministria e Financave
OE	Operatori Ekonomik
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHQ	Qendra për Shërbime me Qytetarë
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
DKA	Drejtorja Komunale e Arsimit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Th	Thesari

LEGJENDA/PËRSHKRIMI



Qëllimi

Ky dokument (tutje procesi) përshkruan Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga dokumentet e gjendjes civile. Procesi i përshkruar më poshtë mbështetet në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale dhe praktikrat e mira gjerësisht të pranuar. Procesi përshkruar hapat në formë përshkruese (narrative) dhe me diagrame që duhet ndjekur gjatë procesit të regjistrimit dhe raportimit të të hyrave na dokumentet e gjendjes civile.

Përdorimi

Procedura Standarde e Operimit (PSO) është një dokument “që frymon” i cili duhet të rishikohet në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare për regjistrimin e të hyrave komunale. Ndryshimet si dhe versioni i përditësuar i PSO duhet t’u komunikohet të gjithë stafit që ndikohen direkt apo indirekt nga kjo PSO dhe palëve të tjera të interesit në komunë.

Kjo PSO gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e PSO-së gjithashtu i ndihmon stafit ekzistues dhe të ri në mbarëvajtjen e detyrave të tyre.

1. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË HYRAVE NGA DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PROCESIN

Titulli i procesit:	Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të të Hyrave nga Dokumentet e Gjendjes Civile
Organizata Buxhetore:	Komuna e Lipjanit
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin Procedurave Standarde të Operimit për regjistrimin dhe raportin e të Hyrave Komunale nga Dokumentet e Gjendjes Civile. PSO evidenton hallkat vendimmarrëse brenda Komunës sa i përket fazave të pranimit, regjistrimit, procedimit, pagesës, arkivimit të faturës.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Versioni:	V-01/2021
Baza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale 2. Ligji Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal 3. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar). 4. Ligji Nr. 04/L-003 Për Gjendjen Civile 5. Ligji vjetor i Buxhetit 6. Rregulla Financiare 03/2010 për Të Hyrat (e rishikuar) 7. Rregulloret Vjetore Komunale për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha 8. Procedura e MFK-së Nr. 7 Të Hyrat 9. Marrëveshjet e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Komunës për të hyrat vetanake.
Pronari i Procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës
Palët kryesore të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar 2. Drejtoria e Administratës 3. Zyrtari e Gjendjes Civile 4. Zyrtari kryesor i të hyrave në komunë 5. Zyrtari përgjegjës për shërbime me qytetarë 6. Personi fizik
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SIMFK) 2. Intraneti i Komunës
Dokumentet/dëshmitë kryesore që gjenerohen gjatë procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fatura dhe/ose kërkesa për pagim 2. Dëshmi për pranimit të faturës (kopje) 3. Dokumentet përcjellësve të pagesave <ol style="list-style-type: none"> a. Raporti i pranimit të mallit në SIMFK b. Urdhër Obligimi për Pagesë c. Urdhërblerja d. Zotimi etj. 4. Numri unik i protokollimit 5. Raportimi i obligimeve të pa paguara

Ndërlidhja:	Nuk ka
Numri i fazave:	14

2. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TË HYRAT NGA DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE: PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT

Procesi i regjistrimit dhe Raportimi të të hyrave nga Dokumentet e Gjendjes Civile						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Planifikimi i të hyrave nga Dokumentet e Gjendjes Civile	1.1 Zyrtari Kryesor Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës bën planifikimin e të hyrave nga lejet e dokumentet e gjendjes civile.	1.Zyrtari Kryesor Financiar 2. Udhëheqësi i Drejtorisë së Administratës	Çdo vit	1.Planifikimi i të hyrave nga dokumentet e gjendjes civile	n/a
2.	Kërkesa për pajisje me dokument të gjendjes civile në zyrë të gjendjes civile dhe E-Kioskë	2.1 Personi fizik në ndonjërin nga zyrat e gjendjes civile të komunës paraqet kërkesë për pajisje me ndonjërin nga dokumentet e gjendjes civile. <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px;"> Dokumentet e gjendjes civile 1. Çertifikata e Lindjes 2. Extrakt i Lindjes 3. Çertifikata e bashkësisë familjare 4. Çertifikata e martesës 5. Çertifikata e vdekjes 6. Çertifikata e shtetësisë 7. Çertifikata e vendbanimit 8. Procesverbali për pranimin e atësisë/amësisë 9. Leje varrimi 10. Dëshmi e vdekjes 11. Vërtetim nga arkivi 12. Vërtetim i ç'lajmërimit të vendbanimit 13. Vërtetimi për regjistrim me vonesë 14. Vërtetim për korrigjim të të dhënave 15. Vërtetim për anulimin e regjistrimit 16. Vërtetim për ndërrimin e të dhënave personale </div>	1.Personi fizik	Nuk ka	1.Kërkesa për pajisje me dokument të gjendjes civile 2. Dokumenti i Gjendjes Civile	1.Ligji Nr. 04/L-003 Për Gjendjen Civile (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

		<p>2.2 Nëse aplikimi për dokument të gjendjes civile bëhet në E-Kioskë, atëherë personi paraqitet në ndonjërin nga e-kioskët.</p> <p>2.3 Personi vendos letërnjoftimin e tij në e-kioskë.</p> <p>2.4 Pas leximit të letërnjoftimit nga e-kioska, personi zgjedh ndonjërin nga dokumentet e gjendjes civile.</p> <p>2.5 Sistemi i kërkon personit të konfirmojë të dhënat personale.</p> <p>2.6 Pas konfirmimit, sistemi i kërkon personit vendosje në parave.</p> <p>2.7 Pas njohjes së parave, sistemi i kërkon të shtyp dokumentin e gjendjes civile.</p> <p>2.8 Personi merr faturën dhe dokumentin.</p>				
3.	Vendosja e të dhënave në Intranet	<p>3.1 Zyrtari përgjegjës i kërkon një dokument personal dhe fut të dhënat personale të aplikuesit në intranetin e komunës ku i shfaqen të dhënat nga regjistri i gjendjes civile, ku edhe konfirmon të dhënat.</p> <p>3.2 Nëse person fizik është i liruar nga pagesa, i paraqet dëshminë zyrtarit përgjegjës dhe lirohet nga pagesa.</p> <p>3.3 Zyrtari përgjegjës i gjendjes civile, vendos informatat e dëshmisë së lirimimit nga pagesa në intranet.</p>	<p>1. Personi fizik ose juridik</p> <p>2. Zyrtari përgjegjës i gjendjes civile</p> <p>3. Arkatari i administratës komunale/bankës</p>	Menjëherë	1. Kërkesa për pajisje me dokument të gjendjes civile	<p>1. Ligji Nr. 04/L-003 Për Gjendjen Civile (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2. Rregulore për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale</p>

		<p>3.4 Sipas kërkesës së aplikuesit, zyrtari përgjegjës i zyrës së gjendjes civile shtyp dokumentin e gjendjes civile.</p> <p>Të gjitha pagesat deri në shumën 10€ bëhen në para të gatshme, ndërsa të gjitha pagesa mbi shumën 10€ paguhen përmes bankës</p> <p>3.5 Nëse personi fizik nuk është i liruar nga pagesa, ai/ajo bën pagesën tek arkatari i administratës komunale në para të gatshme apo për shumat mbi 10€ tek arkatari i bankës.</p> <p>3.6 Zyrtari i Gjendjes Civile i jep një kopje të dëftesës së pagesës personit fizik.</p> <p>3.7 Personi fizik kthen dëshminë tek zyrtari i gjendjes civile dhe merr dokumentin e gjendjes civile.</p>				
4.	Aprovimi i dokumenteve të gjendjes civile në intranet	4.1 Drejtori i Administratës së Komunës në intranetin e komunës i shfaqen të gjitha kërkesat për dokumente të gjendjes civile të cilat i aprovon një-nga-një.	1.Drejtori i Administratës	Nuk ka	Aprovimi në intranetin e komunës	1.Ligji Nr. 04/L-003 Për Gjendjen Civile (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
5.	Dorëzimi i parave tek Arkatari Kryesor i Komunës dhe	5.1 Zyrtari i gjendjes civile gjeneron raport ditor (specifikacion) të pagesave nën 10€.	1.Zyrtari i Gjendjes Civile	1.Çdo ditë	1.Dokumenti i dorëzimit i nënshkruar	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë

	barazimi i të hyrave	<p>5.2 Arkatari i administrates komunale në baza ditore bën barazimin (numërimin) e parave të gatshme.</p> <p>5.3 Nëse shuma e pagesave të gatshme pas numërimit përputhet me raportin ditor të pagesave (specifikacionin) nën 10€, bëhet nënshkrimi i specifikacionit.</p>	2.Arkatari Kryesor i Komunës		2. Raport të pagesave ditore	(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
6.	Gjenerimi i Faturave nga Arkatari i administrates komunale dhe depozitimi i parave në Bankë	<p>6.1 Arkatari i administrates komunale bazuar në shumën financiare, për secilin lloj të të hyrave nga gjendja civile gjeneron faturat (unirefat) e asaj date.</p> <p>6.2 Arkatari i administrates komunale depoziton paratë sipas unirefave për secilën lloj të të hyrave nga gjendja civile në ndonjërin nga bankat komerciale të licensuara nga BQK-ja.</p>	1. Zyrtari i Gjendjes Civile	1.Çdo ditë	1.Dokumenti i depozitimit në bankë	<p>1.Ligji Nr. 04/L-003 Për Gjendjen Civile (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Rregullore për tarifa ngarkesa dhe gjoha komunale</p>
7.	Raportimi i të hyrave nga Banka Qendrore e Kosovës për Thesarin	7.1 Banka Qendrore e Kosovës në baza ditore i dërgon Thesarit raport për të hyrat e datës.	1.Banka Qendrore e Kosovës	1. Çdo ditë	1.Ekstrakt i të hyrave	<p>1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
8.	Regjistrimi i të hyrave	8.1 Thesari bazuar në raportin ditor të BQK-së, bën kategorizimin e të hyrave për komunën përkatëse në raporte të specifikuar ditore.	1.Thesari i Ministrisë së Financave	1. Çdo ditë	Nuk ka	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e

						Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
9.	Kategorizimi/regjistrimi i të hyrave nga komuna ne SIMFK	<p>9.1 Zyrtari kryesor i të hyrave bazuar në ekstraktin ditor të të hyrave të dërguar nga Thesari, bën regjistrimin/shpërndarjen e të hyrave në kategoritë kryesore të të hyrave në SIMFKpërfshirë edhe regjistrimin e të hyrave nga lejet dhe dokumentet e gjendjes civile..</p> <p>9.2 Zyrtari Kryesor i të Hyrave njofton Drejtorinë e Administrates për të hyrat e totale për atë datë.</p>	<p>1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave</p> <p>2.Drejtoria e Administrates</p> <p>3. Zyrtari përgjegjës për gjendje civile</p>	Çdo ditë	Nuk ka	<p>1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
10.	Barazimi i të hyrave	<p>10.1 Zyrtari Kryesor i të Hyrave në baza të rregullta bën barazimin me drejtorinë përkatëse. <i>[barazimi duhet të bëhet çdo muaj, mirëpo varësisht prej volumit dhe nevojës, barazimi mund të bëhet edhe më shpesh mirëpo së pakunjë herë në muaj]</i></p> <p>10.2 Zyrtari i dejtorisë përkatëse takohet me zyrtarin e të hyrave dhe bëjnë barazimin e të hyrave në bazë të dëshmime që kanë</p> <p>10.3 Nëse të hyrat barazohen, atëherë të dy palët e nënshkruajnë një spcifikacion që është bërë barazimi i të hyrave ku ceket muaj, data, lloj të hyrave dhe drejtoria.</p>	<p>1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave</p> <p>2.Zyrtari përgjegjës në drejtorinë përkatëse</p>	1.Çdo muaj	1. Dokumenti i barazimit të të hyrave i nënshkruar (specifikacioni)	n/a


		10.4 Nëse të hyrat nuk barazohet, atëherë diferenca hetohet nga zyrtari i drejtorisë përkatëse dhe zyrtari i të hyrave				
11.	Barazimi vjetor i të hyravendërmjet Komisionit për verifikim dhe barazim të të hyrave me Arkatarin e administrates komunale (opsionale)	<p>11.1 Kryetari i Komunës në konsultim me Drejtorin e Administratës së paku një herë në vit themelon komision për verifikim dhe barazim të të hyrave me arkatarin e administrates komunale.</p> <p>Komisioni sipas gjykimit profesional mund të verifikoj të dhënat dhe të zhvillojë procedura hetuese, të të dhënave të paraqitura nga palët dhe të zgjedh ndonjë mostër për të verifikuar transaksionet dhe dokumentacionin apo edhe të vizitojë arkatarët në teren dhe krahasoj të dhënat.</p> <p>11.2 Komisioni i përbërë prej së paku 3 anëtarëve bën barazon të hyrat ndërmjet arkatarëve individual, arkatarit kryesor dhe zyrtarit kryesor të të hyrave në komunë.</p> <p>11.3 Komisioni bën raport për barazimin e të hyrave vjetore dhe i dërgon raportin Kryetarit të Komunës dhe Drejtorit të Buxhetit dhe Financave, Zyrtarit Kryesor të të Hyrave dhe Zyrtarit Kryesor Financiar.</p>	<p>1.Kryetari i Komunës</p> <p>2. Drejtori i Buxhetit dhe Financave</p>	1.Një herë në vit	<p>1.Vendim për themelim të komisionit</p> <p>2.Raport i komisionit për barazim.</p>	n/a
12.	Alokimi i të hyrave	12.1 Zyrtari Kryesor Financiar i Komunës bën alokimin e rrgullt të të hyrave të cilat bëhen të disponueshme për shpenzim	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Çdo tre muaj	1.Kërkesat për alokim në Thesar	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë


						<p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Rregullore Nr.02/2017 për Alokimin e Fondeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
13.	Shpenzimi i të hyrave	13.1 Të hyrat shpenzohen në kategoritë përkatëse [shih më detajisht procesin e shpenzimeve nga libri i proceseve]	1.Zyrtari Kryesor Financiar	Nuk ka	Nuk ka	<p>1.Rregllore Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p><u>2.</u> Libri i Proceseve</p>
14.	Raportimi në Pasqyra Vjetore Financiare dhe raportimi i rregullt financiar	14.1 Zyrtari Kryesor Financiar bën raportimin e të hyrave nga SIMFK në Pasqyra Vjetore Financiare në fundvit dhe raportet e rregullta financiare.	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Deri me 31 Janar të vitit pasues	<p>1.Pasqyrat Vjetore Financiare</p> <p>2. Raportimet e rregullta financiare</p>	<p>1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>


						<p>2.Rregullore Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
Fundi i procesit						

3. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TË HYRAT NGA DOKUMENTET E GJENDJES CIVILE: PARAQITJA E PROCESIT PËRMES DIAGRAMEVE

Procesi i Regjistrimit dhe Raportimi të të Hyrave nga Dokumentet e Gjendjes Civile









Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit
Opština Lipjan
Municipality of Lipjan

**PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT
PËR
REGJISTRIMIN DHE RAPORTIMIN E TË
HYRAVE KOMUNALE
NGA
DHËNIA NË SHFRYTËZIM E PRONËS SË
PALUAJTSHME KOMUNALE**

Gusht, 2021









PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
LEGJENDA/PËRSHKRIMI	4
1. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të hyrave komunale nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale: Të dhënat e përgjithshme për procesin	6
2. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga të hyrat nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale: Procedurat Standarde të Operimit	8
3. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të të hyrave komunale nga të hyrat nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale: Paraqitja e procesit përmes diagrameve	15

SHKURTESAT

DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF	Ministria e Financave
OE	Operatori Ekonomik
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QSHQ	Qendra për Shërbime me Qytetarë
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
DKA	Drejtorja Komunale e Arsimit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Th	Thesari
DTP	Departamenti i Tatimit në Pronë
NjTP	Njësia e Tatimit në Pronë
BQK	Banka Qëndrore e Kosovës

LEGJENDA/PËRSHKRIMI



Qëllimi

Ky dokument (tutje procesi) përshkruan Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale. Procesi i përshkruar më poshtë mbështetet në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale dhe praktikrat e mira gjerësisht të pranuar. Procesi përshkruan hapat në formë përshkruese (narrative) dhe me diagrame që duhet ndjekur gjatë regjistrimit dhe raportimit të të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale.

Përdorimi

Procedura Standarde e Operimit (PSO) është një dokument “që frymon” i cili duhet të rishikohet në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale. Ndryshimet si dhe versioni i përditësuar i PSO duhet t’u komunikohet të gjithë stafit që ndikohen direkt apo indirekt nga kjo PSO dhe palëve të tjera të interesit në komunë.

Kjo PSO gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësisë të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e PSO-së gjithashtu i ndihmon stafit ekzistues dhe të ri në mbarëvajtjen e detyrave të tyre.

1. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË HYRAVE KOMUNALE NGA DHËNIA NË SHFRYTËZIM E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PROCESIN

Titulli i procesit:	Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të të Hyrave Komunale nga Dhënia në Shfrytëzim e Pronës së pa Luajtshme Komunale
Organizata Buxhetore:	Komuna e Lipjanit
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin Procedurave Standarde të Operimit për regjistrimin dhe raportin e të Hyrave nga Dhënia në Shfrytëzim e Pronës së pa Luajtshme Komunale.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Versioni:	V-01/2021
Baza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale 2. Ligji Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal 3. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar). 4. Ligji për dhënien në shfrytëzim të dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 5. Ligji vjetor i Buxhetit 6. Rregulla Financiare 03/2010 për Të Hyrat (e rishikuar) 7. Rregulloret Vjetore Komunale për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba 8. Procedura e MFK-së Nr. 7 Të Hyrat 9. Marrëveshjet e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Komunës për të hyrat vetanake.
Pronari i Procesit:	1. Kryetari i Komunës
Palët kryesore të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori për Buxhet dhe Financa / Zyrtari Kryesor Financiar Komunal 2. Drejtorët e Pronës dhe Katastrit 3. Drejtoria e Shërbimeve Publike 4. Zyrtari kryesor i të hyrave në komunë 5. Zyrtari përgjegjës për shërbime me qytetarë 6. Operatori Ekonomik/ personi fizik/entitet tjetër juridik
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SIMFK) 2. Intraneti i Komunës
Dokumentet/dëshmitë kryesore që gjenerohen gjatë procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi i të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e pronës së pa luajtshme komunale 2. Lista e pronave të paluajtshme 3. Vendimi për formim të komisionit vlerësues 4. Njoftimi publik për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale 5. Propozimi i ofertës së përzgjedhur 6. Kontrata e nënshkruar për shfrytëzim të pronës komunale 7. Fatura për pagesë 8. Dëshmi për pranim të faturës (kopje) 9. Raporti i të hyrave ditore nga BQK-ja

	<p>10. Dokumenti i barazimit të të hyrave (specifikacioni)</p> <p>11. Dokumentet përcjellësve të pagesave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raporti i pranimit të mallit në SIMFK • Urdhër Obligimi për Pagesë • Urdhër blerja • Zotimi etj. <p>12. Plani mujor i alokimeve</p> <p>13. Raportet periodike financiare</p> <p>14. Pasqyrat Vjetore Financiare</p>
Ndërlidhja:	Procesin e shpenzimeve
Numri i fazave:	15

**2. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TË HYRAT NGA DHËNIA NË SHFRYTËZIM E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE:
PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT**

Procesi i regjistrimit dhe Raportimi të të hyrave nga dhënia me qira e pronës së paluajtshme komunale						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
1.	Planifikimi i të hyrave dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme komunale	1.1 Zyrtari Kryesor Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis bën planifikimin e të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e pronave dhe hapësirave publike komunale.	1.Zyrtari Kryesor Financiar 2. Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis	Çdo vit	1.Planifikimi i të hyrave nga urbanizmi	n/a
2.	Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës dhe propozimi për dhënien në shfrytëzim	2.1 Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës për miratim paraprak pronën e paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim. 2.2 Kuvendi merr vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale 2.3 Komuna publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues.	1.Kryetari i Komunës 2.Kuvendi i Komunës	1.Deri me 31 dhjetor	1.Lista e pronave të paluajtshme 2. Propozimi i Kryetarit 3.Miratimi i Kuvendit të Komunës	1.Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
3.	Njoftimi publik	3.1 Pas marrjes së vendimit paraprak nga kuvendi i komunës, komuna bën publikimin e njoftimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. 3.2 Njoftimi publikohet në faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve të	1.Zyra për komunikim	1.Pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit	1.Njoftimi publik për dhënien në shfrytëzim të	1.Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së

		komunës në vendin ku gjendet prona dhe së paku në ndonjërin nga mediat lokale të shkruara dhe elektronike.			pronave komunale	paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
4.	Procedurat e ankandit publik, shprehje së interesit dhe negociatave të kryetarit të komunës	<p>4.1 Komuna zhvillon procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale përmes ndonjërisë nga procedurat e më poshtme</p> <p>a. Ankandit publik</p> <p>b. Shprehjes së interesit; dhe</p> <p>c. Negociatave të kryetarit të komunës</p> <p>4.2 Prona e cila do të jepet në shfrytëzim duhet të jetë pjesë e listës së publikuar për pronat e paluajtshme.</p>	n/a	Nuk ka	Nuk ka	<p>1.Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
5.	Paraqitja e ofertave, vlerësimi dhe zgjedhja e përfituesit	<p>5.1 Personat fizik dhe juridik mund të paraqesin ofertat e tyre për marrjen në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës.</p> <p>5.2 Për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, formohet komision vlerësues.</p> <p>5.3 Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komisionit aprovet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë.</p> <p>5.4 Komisioni vlerësues pas pranimit të ofertave bën vlerësimin e tyre në përputhje</p>	<p>1.Personat fizik ose juridik</p> <p>2.Komisioni vlerësues</p>	1.Pesëmbëdhjetë ditë (15) kalendarike pas shpalljes së njoftimit	<p>1.Vendimi për formim të komisionit vlerësues</p> <p>2.Propozimi i ofertës së përzgjedhur</p>	<p>1.Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

		me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik. 5.5 Komisioni propozon ofertën e përzgjedhur.				
6.	Nënshkrimi i Kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	6.1 Pas përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesave, komisioni propozon ofertën e përzgjedhur dhe e procedon te Kryetari i Komunës. a. Për rastet me periudhë shfrytëzimi afatshkurtër, Kryetari i Komunës nënshkruan kontratë me fituesin. b. Për rastet me periudhë shfrytëzimi afatgjatë, Kuvendi i Komunës me shumicë votash të anëtarëve prezent dhe që votojnë vendos për ofertën e përzgjedhur nga komisioni 6.2 Për zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, obligohet Kryetari i Komunës të nënshkruan kontratë me fituesin.	1.Personat fizik ose juridik 2.Komisioni vlerësues 3.Kuvendi i Komunës 4.Kryetari i Komunës	Nuk ka	1.Kontrata e nënshkruar	1.Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
7.	Kalkulimi i shumës për pagesë dhe gjenerimi i faturës	7.1 Pas nënshkrimit të kontratës, personi fizik ose juridik i përzgjedhur paraqitet tek zyrtari përgjegjës në drejtorinë e Pronës dhe Katastrit dhe bazuar në kontratën e lidhur bën kërkesë për pajisje me faturë. 7.2 Zyrtari përgjegjës në drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis në intranetin e komunës fut të dhënat e personit juridik/fizik dhe gjeneron faturën (Uniref) me shumën përkatëse.	1.Zyrtari përgjegjës në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis 2.Personi fizik ose juridik	Çdo muaj	1.Fatura për pagesë	1.Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

						2. Rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale
8.	Pagesa e Faturës	<p>8.1 Fatura merret dhe paguhet nga personi apo subjekti juridik dhe pagesa bëhet në EUR në ndonjërin nga bankat apo institucionet e licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.</p> <p>8.2 Personi apo subjekti juridik e sjell një kopje të dëshmisë së pagesës tek zyrtari i Drejtorisë së Pronës dhe Katastrit.</p>	1. Personi fizik ose subjekti juridik	1. Menjëherë	1. Kopje dëshmisë së pagesës	<p>1. Rregullore Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
9.	Raportimi i të hyrave nga Banka Qendrore e Kosovës për Thesarin	9.1 Banka Qendrore e Kosovës në baza ditore i dërgon Thesarit raport për të hyrat e datës.	1. Banka Qendrore e Kosovës	1. Çdo ditë	1. Ekstrakt i të hyrave	<p>1. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
10.	Regjistrimi i të hyrave	<p>10.1 Thesari bazuar në raportin ditor të BQK-së, bën kategorizimin e të hyrave për komunën përkatëse në raporte të specifikuar ditore.</p> <p>10.2</p>	1. Thesari i Ministrisë së Financave	1. Çdo ditë	Nuk ka	1. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë


						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
11.	Kategorizimi/regjistrimi i të hyrave nga komuna ne SIMFK	<p>11.1 Zyrtari kryesor i të hyrave bazuar në ekstraktin ditor të të hyrave të dërguar nga Thesari, bën regjistrimin/shpërndarjen e të hyrave në kategoritë kryesore të të hyrave në SIMFK përfshirë edhe regjistrimin e të hyrave nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale.</p> <p>11.2 Zyrtari Kryesor i të Hyrave njofton Drejtorinë Përkatëse për të hyrat e totale për atë datë.</p>	1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave	Çdo ditë	Nuk ka	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
12.	Barazimi i të hyrave	<p>12.1 Zyrtari Kryesor i të Hyrave në baza të rregullta bën barazimin me drejtorinë përkatëse.</p> <div data-bbox="555 885 1048 1161" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px; margin: 10px 0;"> <p>Barazimi i të hyrave Barazimi duhet të bëhet çdo muaj, mirëpo varësisht prej volumit dhe nevojës, barazimi mund të bëhet edhe më shpesh mirëpo së pak një herë në muaj</p> </div> <p>12.2 Zyrtari i dejtorisë përkatëse takohet me zyrtarin e të hyrave dhe bëjnë barazimin e të hyrave në bazë të dëshmive që kanë</p>	<p>1.Zyrtari Kryesor i të Hyrave</p> <p>2.Zyrtari përgjegjës në drejtorinë përkatëse</p>	1.Çdo muaj	1. Dokumenti i barazimit të të hyrave i nënshkruar (specifikacioni)	n/a


		<p>12.3 Nëse të hyrat barazohen, atëherë të dy palët e nënshkruajnë një specifikacion që është bërë barazimi i të hyrave ku ceket muaj, data, lloj të hyrave dhe drejtoria.</p> <p>12.4 Nëse të hyrat nuk barazohet, atëherë diferenca hetohet nga zyrtari i drejtorisë përkatëse dhe zyrtari i të hyrave</p>				
13.	Alokimi i të hyrave	13.1 Zyrtari Kryesor Financiar i Komunës bën alokimin e rrgullt të të hyrave të cilat bëhen të disponueshme për shpenzim	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Çdo muaj/sipas nevojës më shpesh	1.Kërkesat për alokim në Thesar	<p>1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Rregullore Nr.02/2017 për Alokimin e Fondeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
14.	Shpenzimi i të hyrave	14.1 Të hyrat shpenzohen në kategoritë përkatëse [shih më detajisht procesin e shpenzimeve nga libri i proceseve]	1.Zyrtari Kryesor Financiar	Nuk ka	Nuk ka	1.Rregllore Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parave Publike


						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2.Libri i Proceseve
15.	Raportimi në Pasqyra Vjetore Financiare dhe raportimi i rregullt financiar	15.1 Zyrtari Kryesore Financiar bën raportimin e të hyrave nga SIMFK në Pasqyra Vjetore Financiare në fundvit dhe raportet e rregullta financiare.	1.Zyrtari Kryesor Financiar	1.Deri me 31 Janar të vitit pasues	1.Pasqyrat Vjetore Financiare 2. Raportimet e rregullta financiare	1.Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). 2.Rregullore Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
Fundi i procesit						

3. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË TË HYRAVE KOMUNALE NGA TË HYRAT NGA DHËNIA NË SHFRYTËZIM E PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE: PARAQITJA E PROCESIT PËRMES DIAGRAMEVE

Procesi i Regjistrimit dhe Raportimi të të Hyrave nga dhënia në shfrytëzim e pronave të paluajtshme komunale









Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Lipjanit
Opština Lipjan
Municipality of Lipjan

**PROCEDURA STANDARDE E OPERIMIT
PËR
MENAXHIMIN E PASURIVE KOMUNALE
JO FINANCIARE KAPIALE
DHE
SISTEMI PËR KONTROLLIMIN E
PASURIVE**

Gusht, 2021









PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
LEGJENDA/PËRSHKRIMI	4
1. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të pasurive komunale: Të dhënat e përgjithshme për procesin	6
2. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të pasurive jo financiare kapitale: Procedurat Standarde të Operimit	8
3. Procesi i regjistrimit dhe raportimit të pasurive jo financiare kapitale: Paraqitja e procesit përmes diagrameve	28

SHKURTESAT

DBF	Drejtori për Buxhet dhe Financa
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF	Ministria e Financave
OE	Operatori Ekonomik
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar në Kosovë
PSO	Procedurë Standarde e Operimit
PIP	Programi i Investimeve Publike
SIMZHB	Sistemi për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit
DKA	Drejtorja Komunale e Arsimit
UOP	Urdhër Obligimin për Pagesë
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
ZP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Th	Thesari
NjTP	Njësia e Tatimit në Pronë

LEGJENDA/PËRSHKRIMI



Qëllimi

Ky dokument (tutje procesi) përshkruan Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për regjistrimin, administrimin dhe raportimin e pasurive jo-financiare në komunë. Procesi i përshkruar më poshtë mbështetet në Ligjet e Republikës së Kosovës, Udhëzimet Administrative, Rregulloret dhe procedurat e institucioneve qendrore dhe lokale dhe praktikrat e mira gjerësisht të pranuar. Procesi përshkruan hapat në formë përshkruese (narrative) dhe me diagrame që duhet ndjekur gjatë regjistrimit dhe raportimit të pasurive komunale.

Përdorimi

Procedura Standarde e Operimit (PSO) është një dokument i “që frymon” i cili duhet të rishikohet në baza të rregullta për të reflektuar ndryshimet e mundshme në kornizën ligjore apo rregullative dhe përmirësimet në praktikrat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare për procesim të faturave. Ndryshimet si dhe versioni i përditësuar i PSO duhet t’u komunikohet të gjithë stafit që ndikohen direkt apo indirekt nga kjo PSO dhe palëve të tjera të interesit në komunë.

Kjo PSO gjithashtu ndihmon në caktimin e qartë të vijave të përgjegjësive të të gjithë palëve të përfshira në proces si dhe hallkave që duhen ndjekur për të siguruar integritetin e funksioneve të institucioneve përkatëse. Nga ana tjetër, një përmbledhje e detajuar e PSO-së gjithashtu i ndihmon stafit ekzistues dhe të ri në mbarëvajtjen e detyrave të tyre.

1. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË PASURIVE KOMUNALE: TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PROCESIN

Titulli i procesit:	Procesi i Regjistrimit dhe Raportimit të Pasurive Komunale
Organizata Buxhetore:	Komuna e Lipjanit
Qëllimi / Objektivat / Fushëveprimi i/e procesit:	Procesi ka për qëllim përshkrimin narrativ dhe përmes diagrameve të Procedurave Standarde të Operimit për regjistrimin dhe raportin e pasurive komunale jo-financiare kapitale mbi 1,000€. Procesi është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përshkruan hallkat dhe hapat kryesorë që duhet ndjekur gjatë regjistrimit dhe prezantimit të pasurive në Pasqyra Vjetore Financiare. Ndërsa pjesa e II ka të bëjë me sistemin e kontrollit të pasurive financiare i cili ndodh së paku një herë në vit dhe është pjesë integrale e procesit të menaxhimit të pasurive.
Përgjegjësi për rishikim të procesit:	Drejtorja për Buxhet dhe Financa.
Versioni:	V-01/2021
Baza ligjore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe plotësuar). 2. Rregulla financiare Nr. 01-2013 MF për Shpenzimin e Parasë Publike 3. Rregulla Financiare Nr.02/2013/MF për Menaxhimin e Pasurisë Jo-financiare në Organizatat Buxhetore 4. Procedura e MFK-së Nr. 5 Menaxhimi i Pasurive 5. Procedura e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit Nr. 6 – Autorizimet dhe Pagesat 6. Udhëzim Administrativ Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale
Pronari i Procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryetari i Komunës
Palët kryesore të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtori për Buxhet dhe Financa 2. Drejtorët e Drejtorive Komunale 3. Kryetari i Komunës 4. Zyrtari i Pasurive 5. Komisioni për Vlerësimin e Pasurive 6. Komisioni për Inventarizimin e Pasurive 7. Zyrtari Kryesor Financiar 8. Zyrtari i Pranimit/Logjistikës 9. Zyrtari Përgjegjës në Projektin e Investimeve Publike(PIP) 10. Zyrtari i Depos 11. Menaxheri i Prokurimit 12. Operatori Ekonomik/ personi fizik/entitet tjetër juridik
Sistemet e TI të përfshira në proces:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SIMFK) 2. Aplikacioni E-Pasuria
Dokumentet/dëshmitë kryesore që gjenerohen gjatë procesit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi i Investimeve Kapitale 2. Lista e Projekteve Kapitale 3. Dokumentet e Prokurimit 4. Marrëveshjet e Mirëkuptimit 5. Raporti i Pranimit Teknik 6. Vendimi i themelimit të komisionit të pranimit teknik

	<p>7. Vendim për themelimin e komisionit të vlerësimit për pasuritë që do shiten</p> <p>8. Njoftimi publik për shitjen e pasurisë</p> <p>9. Vendim për themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave</p> <p>10. Fatura për shitjen e pasurive</p> <p>11. Vendimi për themelimin e komisionit të inventarizimit</p> <p>12. Vendimi për themelimin e komisionit të vlerësimit</p> <p>13. Raporti i inventarizimit</p> <p>14. Raporti i vlerësimit</p> <p>15. Pasqyrat Vjetore Financiare</p> <p>16. Dokumentet përcjellëse të pagesave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raporti i pranimit të mallit në SIMFK • Urdhër Obligimi për Pagesë • Urdhër blerja • Zotimi, etj.
Ndërlidhja:	<p>Procesin e Shpenzimeve Kapitale</p> <p>Procesin e Prokurimit</p>
Numri i fazave:	28

2. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE RAPORTIMIT TË PASURIVE JO FINANCIARE KAPITALE: PROCEDURAT STANDARDE TË OPERIMIT

PJESA I: Procesi i regjistrimit dhe raportimit të pasurive jo-financiare kapitale						
Hapat	Aktiviteti	Aktivitetet e Kontrollit	Përgjegjësi	Afatet	Dokumentet	Korniza ligjore
Nën-Procesi: Planifikimi, buxheti dhe prokurimi						
1.	Planifikimi i blerjeve të pasurive	<p>1.1 Drejtori i Buxhetit dhe Financave si bartës i procesit të buxhetit komunal në bashkëpunim me të gjithë mbajtësit e buxheteve bëjnë planifikimin dhe/ose projektimin e blerjeve të pasurive ose ndërtimit të tyre.</p> <p>1.2 Drejtori i Buxhetit dhe Financave bazuar në udhëzimin administrativ për klasifikimin e projekteve kapitale dhe shpenzimeve kapitale klasifikon shpenzimet.</p> <div style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 5px; margin-top: 10px;"> <p>Kriteret për projekte kapitale</p> <ul style="list-style-type: none"> -Shpenzimet e investimit janë mbi 1,000€ dhe zgjasin mbi një (1) vit -Investimi përmirëson, zgjeron kapacitetet, ulë shpenzimet apo përfitime të ngjashme -Investimi ofron përfitime gjatë shumë viteve -Ndikon në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, dhe ekonomik të vendit apo/dhe arritjen e objektivave të organizatës buxhetore </div>	<p>1. Zyrtari përgjegjës administrativ/financiar</p> <p>2.Drejtorët e drejtorive komunale</p>	Çdo vit	1.Planifikimi i investimeve kapitale	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Rregulla financiare Nr. 01-2013 MF për Shpenzimin e Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>3.Udhëzimi Administrativ Nr.04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe klasifikimin e</p>

						shpenzimeve të projekteve kapitale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
2.	Buxheti dhe vendosja e projekteve në platformën Programin e Investimeve Publike (PIP)	<p>2.1 Drejtori i Buxhetit dhe Financave së bashku me mbajtësit e buxhetit, zhvillojnë procesin e buxhetimit <i>[më detajisht shif procesin e buxhetit në Librin e Proceseve]</i></p> <p>2.2 Drejtori Buxhetit dhe Financave së bashku me mbajtësit e buxhetit krijojnë listën e projekteve kapitale e cila nënshkruhet nga Kryetari i Komunës</p> <p>2.3 Buxheti i komunës aprovohet në Kuvend Komunal.</p> <p>2.4 Zyrtari i përgjegjës për projekte kapitale i vendos të gjitha projektet kapitale të aprovuara në Programin e Investimeve Publike.</p>	<p>1.Drejtori i Buxhetit dhe Financave</p> <p>2.Kryetari i Komunës</p> <p>3.Zyrtari përgjegjës për PIP</p>	Pas aprovimit të listës së projekteve	1.Lista e projekteve kapitale e aprovuar	<p>1. Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p> <p>2.Libri i Proceseve</p>
3.	Prokurimi [opsionale]	<p>12.1 Menaxheri i Prokurimit zhvillon procedurat e prokurimit të pasurive kapitale <i>[më detajisht shif procesin e prokurimit në Librin e Proceseve]</i></p> <p>12.2 Pas zhvillimit të procedurave të prokurimit, nënshkruhet kontrata me operatorin ekonomik.</p>	1.Menaxheri i Prokurimit	Afat sipas Ligjit të prokurimit Publik	1.Dokumentet e prokurimit	<p>1.Ligji i Prokurimit Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>

Nën-Procesi: Blerja (përvetësimi) i pasurive						
4.	Blerja e pasurive mbi 1,000€	4.1 Nëse pasuria e blerë është e lëvizshme, atëherë drejtoria përkatëse komunale inicion procedurat e blerjes dhe përgatitë urdhër-blerjen për pasurinë në fjalë <i>[më detajisht rreth procesit të shpenzimeve kapitale, shif Librin e Proceseve]</i>	1.Drejtori i drejtorisë përkatëse 2.Zyrtari Kryesor Financiar	n/a	1.Urdhër blerja	1.Rregulla financiare Nr. 01-2013 MF për Shpenzimin e Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
5.	Ndërtimi ose bashkëfinancimi i pasurive	5.1 Nëse pasuria është ndërtim nga komuna, atëherë zhvillohen procedurat e projektimit të të projektit kapital <i>[më detajisht rreth procesit të zhvillimit të projektit për investimeve kapitale, shif procesin e shpenzimeve kapitale në Librin e Proceseve]</i> . 5.2 Nëse pasuria ndërtohet si bashkëfinancim, Kryetari i Komunës në bashkëpunim me organizatën buxhetore bashkë financuese nënshkruajnë marrëveshje të mirëkuptimit për ndërtim të pasurisë kapitale. 5.3 Nëse pjesëmarrja e financimit është më e lartë se 50%, procedurat e prokurimit zhvillohen nga organizata buxhetore që financon mbi 50% të projektit apo sipas marrëveshjes ndërmjet tyre.	1.Kryetari i Komunës 2.Udhëheqësi i organizatës buxhetore bashkë financuese	n/a	1.Procedurat e Prokurimit 2.Marrëveshje mirëkuptimi për bashkë-financim.	1.Ligji i Prokurimit Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) . 2.Rregulla financiare Nr. 01-2013 MF për Shpenzimin e Parasë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .

6.	Dhurimet e pasurive kapitale mbi 1,000€	<p>6.1 Nëse pasuritë kapitale pranohen nga komuna si donacion nga ndonjë organizatë tjetër buxhetore, organizatë ndërkombëtare ose kompani private, atëherë Zyrtari i Pasurisë i regjistron ato në regjistrin kontabël në SIMFK.</p> <p>6.2 Kryetari i Komunës në emër të komunës bën marrëveshje mirëkuptimi me organizatën e cila dhuron pasuritë kapitale që shërben si dokument me të cilën i kalon pronësinë e pasurive komunës.</p>	<p>1.Kryetari i Komunës</p> <p>2.Udhëheqësi i organizatës që jep donacion pasuritë</p> <p>3. Zyrtari i Pasurive</p>	Nuk ka	<p>1.Marrëveshje mirëkuptimi</p> <p>2.Lista e pasurive</p> <p>3.Dokumentet mbështetëse të pasurive</p>	<p>1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
7.	Transferet e pasurive mbi 1,000€ nga organizatat tjera buxhetore	7.1 Kryetari i Komunës në emër të komunës bën marrëveshje mirëkuptimi me organizatën e cila i transferon pasuritë kapitale që shërben si dokument me të cilën i kalon pronësinë e pasurive komunës.	1.Udhëheqësi i organizatës buxhetore	Nuk ka	<p>1. Marrëveshje mirëkuptimi</p> <p>2.Lista e pasurive të transferuara</p> <p>3.Dokumentet mbështetëse të pasurive</p> <p>4.Kërkesë për transfer në Ministri të Financave</p>	<p>1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
Nën-Procesi: Pranimi i pasurive mbi 1,000€						
8.	Pranimi i pasurive mbi 1,000€ nga blerja	8.1 Nëse pasuritë e blera pranohen përmes Depos Qendore të Organizatës Buxhetore,	1.Zyrtari i Pranimi/Logjisti kës	Nuk ka	1.Fletëdërgesa	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e

		<p>atëherë Operatori Ekonomik sjell pasuritë e lëvizshme së bashku me fletëdërgesën.</p> <p>8.2 Zyrtari i Pranimit/Logjistikës verifikon nëse</p> <ol style="list-style-type: none"> a. pasuritë e dërguara janë në sasinë e porositur; b. gjendja fizike përputhet me përshkrimin në fletëdërgesë; c. nëse ka ndonjë dëmtim të dukshëm të pasurive; dhe d. nëse përputhen me kushtet e urdhër blerjes (porosinë), dhe/ose kontratë. <p>8.3 Zyrtari i Pranimit/Logjistikës verifikon nëse pasuritë e sjellura janë sipas kërkesave të kontratës dhe në përputhje me urdhër blerjen</p> <p>8.4 Nëse pasuritë e sjellura janë në rregull, fletëdërgesa pranohet dhe nënshkruhet nga Zyrtari i Pranimit/Logjistikës.</p> <p>8.5 Nëse pasuritë e blera pranohen drejtëpërdrejtë nga furnitori pa kaluar nga depoja qendrore, pasuritë dërgohen direkt tek pranuesi i pasurisë.</p> <p>8.6 Zyrtari i Pranimit/Logjistikës pranon pasuritë dhe verifikon nëse pasuritë e sjellura janë sipas kërkesave të kontratës dhe në përputhje me urdhër blerjen.</p> <p>8.7 Nëse pasuritë e sjellura janë në rregull, fletëdërgesa pranohet dhe nënshkruhet nga Zyrtari i Pranimit/Logjistikës.</p>				<p>Pasurisë Jo Financiare në Organizatave Buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
--	--	--	--	--	--	--

		8.8 Nëse pasuritë e sjellura nuk janë në përputhje me kontratën dhe urdhërblenjen, ato nuk duhet të pranohen. Pasuria në fjalë duhet t'i kthehet furnitorit të mbështetur me arsyetimin mos pranimit				
9.	Pranimi i pasurive mbi 1,000€ nga Ndërtimi	<p>9.1 Nëse pasuritë janë ndërtuar, atëherë ato kalojnë përmes ciklit të procesit të projekteve siç janë planifikimit të projektit, aprovimit, zhvillimit të projektit ndërtimor, buxhetimit, prokurimit, dhe ndërtimit.</p> <p>9.2 Kryetari i Komunës themelon komision për pranimin teknik të projektit kapital.</p> <p>9.3 Komisioni i pranimin teknik verifikon gjendjen në teren dhe krahason me kontratën, parametat, projektin dhe përpërgatitë raport përfundimtar të pranimin.</p> <p>9.4 Pasi pasuritë të pranohen teknikisht, dhe i gjithë dokumentacioni plotësohet, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e projektit kapital në regjistrin kontabël në SIMFK</p>	<p>1.Kryetari i Komunës</p> <p>2.Komisioni i Pranimin Teknik</p> <p>3.Zyrtari i Pasurisë</p>	Nuk ka	<p>1.Raporti i Pranimin Teknik</p> <p>2.Vendimi i themelimit të komisionit të pranimin teknik</p>	<p>1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare në Organizatat Buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
10.	Pranimi i pasurive nga Dhurimet	10.1 Organizata që i dhuron pasuritë i ofron dokumentacionin mbështes siç parashihet edhe në Memorandum Mirëkuptimi komunës lidhur me listën e plotë të pasurive, gjendjen e tyre, kostot historike ose vlerën neto në libra dhe dokumentacionin tjetër mbështetës të pronësisë, çertifikata të ndryshme, etj.	<p>1.Komisioni i vlerësimit të pasurive</p> <p>2.Zyrtari i Pasurisë</p>	Nuk ka	<p>1.Memorandum Mirëkuptimi për dhurim të pasurive</p> <p>2.Dokumentet mbështetëse të pasurive</p>	<p>1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare në Organizatat Buxhetore</p>

		<p>10.2 Në rast se organizata që i dhuron pasuritë, nuk ka informacione tjera mbështetëse për pasuritë e dhuruara, atëherë Kryetari i Komunës themelon komision për vlerësimin e pasurive.</p> <p>10.3 Komisioni i vlerësimit bën vlerësimin e pasurive të pranuar si dhuratë duke i dhënë një vlerë pasurive marrë për bazë aspektet e më poshtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjendjen e pasurive; • çmimin e tregut për të njëjtën pasuri ose çmime referente; • vitet e pritura të përdorimit; • kosto e blerjes; • përfitimet ekonomike nga përdorimi i pasurisë; dhe • qëllimin e përdorimit, etj. <p>10.4 Komisioni i vlerësimit përgatitë raport me shkrim lidhur me të dhënat dhe gjendjen e dhe vlerën e pasurive dhe i dërgon një kopje zyrtarit të pasurisë.</p> <p>10.5 Zyrtari i pasurisë i regjistron të gjitha pasuritë e vlerësuara në regjistrin e pasurive kontabël në SIMFK dhe regjistrin e përgjithshëm të pasurive.</p>				<p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
11.	Pranimi i pasurive nga Transferet nga	<p>11.1 Kryetari i Komunës themelon komision të veçantë për vlerësim të pasurive që do të transferohen nga një organizatë buxhetore tek një organizatë tjetër buxhetore.</p>	<p>1.Kryetari i Komunës</p> <p>2.Komisioni i vlerësimit</p>	Nuk ka	1.Komision për vlerësimin e pasurive	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në

	organizatat buxhetore	<p>11.2 Komisioni i vlerësimit bën vlerësimin e pasurive të cilat do të transferohen tek një organizatë tjetër buxhetore dhe përgatitë raport me shkrim lidhur me të dhënat dhe gjendjen e pasurive.</p> <p>11.3 Udhëheqësi i organizatës buxhetore që transferon pasuritë bën marrëveshje mirëkuptimi me organizatën buxhetore si pranuese e pasurisë duke bashkangjitur listën e pasurive të transferuara dhe përshkruar qëllimin e dhënjes së pasurisë si dhuratë apo transfer.</p> <p>11.4 Organizata buxhetore që transferon pasuritë e saj bën kërkesë tek Ministria e Financave për largimin e pasurive nga regjistri kontabël i organizatës dhe transferin e pronësisë tek organizata përfituese.</p>	<p>3.Zyrtari i Pasurisë</p> <p>4.Ministria e Financave</p>		<p>2.Raporti i komisionit të vlerësimit</p> <p>3.Kërkesë në MF për transfer të pasurive</p>	<p>Organizatat Buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
Nën-Procesi: Deponimi dhe ruajtja e pasurive						
12.	Marrja e pasurisë në depo	<p>12.1. Pasuritë e pranuar nga Zyrtari i Pranimit/Logjistikës vendosen në depon kryesore të Komunës.</p> <p>12.1.1. Zyrtari i Pranimit/Logjistikës do të vendoset nën Departamentin e Administratës së Përgjithshme të organizatës buxhetore.</p>	1.Zyrtari i depos	Nuk ka	1.Fletëpranimi në depo	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare Organizatat Buxhetore Jo në

						(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
13.	Ruajta e pasurisë	13.1. Pasuritë vendosen në një vend të përshtatshëm dhe ruhen nga dëmtimi, vjedhja, çasja e pa autorizuar, tjetërsimi, etj.	1.Zyrtari i depos	Menjëherë	Nuk ka	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
Nën-procesi: Regjistrimi i pasurive						
14.	Regjistrimi në Regjistrat Kontabël (SIMFK)	14.1. Zyrtari i Pasurisë bazuar në informacionet e ofruara nga departamenti i financave regjistron pasuritë në regjistrin kontabël të SIMFK.	1.Zyrtari i Pasurisë	Menjëherë	Nuk ka	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
15.	Regjistrimi në Regjistrin e	15.1. Përveç regjistrin kontabël, zyrtar i pasurisë regjistron pasuritë edhe në regjistrin e përgjithshëm të pasurive.	1.Zyrtari i Pasurisë	Menjëherë	Nuk ka	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e

	Përgjithshëm të Pasurive					Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).
Nën-procesi:Regjistrimi i pasurive në proces të investimeve në vijim dhe përmirësimet e pasurisë jo-financiare						
16.	Regjistrimi i pasurive në proces të investimeve në vijim	<p>16.1. Zyrtari pasurisë regjistron pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim.</p> <p>16.2. Në rast se pasuritë blihen ose ndërtohen për organizatat tjera buxhetore, atëherë zyrtari i pasurisë i regjistron ato si pasuri në vijim në regjistrin e pasurive të organizatës financuese deri në momentin kur pasuria i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, ku zyrtari i pasurisë e mbyll llogarinë e investimeve në vijim.</p> <p>16.3. Pasuritë e regjistruara si në vijim nuk zhvlerësohen.</p> <p>16.4. Pas përfundimit të procesit të investimit në vijim, zyrtari i pasurisë i'a ndrron statusin e pasurisë nga në vijim në pasuri në përdorim dhe zbaton zhvlerësimin.</p>	1.Zyrtari i pasurive	Menjëherë	Nuk ka	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).

17.	Përmirësimet e pasurisë	<p>17.1. Në rast se blerja e pasurive ka të bëjë me përmirësimin e pasurisë jo financiare, ato regjistrohen në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurisë jo financiare kapitale.</p> <p>17.2. Zyrtar i pasurisë identifikon numrin unik identifikues të (ID) e pasurisë ekzistuese në regjistrin kontabël në SIMFK dhe e hapë regjistrin e pasurisë ku i'a shton vlerën e përmirësimit kostos totale të pasurisë.</p> <div data-bbox="562 647 1061 1286" style="background-color: #4a7ebb; color: white; padding: 10px;"> <p>Përmirësimet e Pasurisë</p> <p>Janë shpenzime kapitale që ndryshojnë ose modernizojnë pasuritë të cilat ja zgjasin jetën e përdorimit ose përmirësojnë dukshëm funksionalitetin. Si për shembull</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritjen e produktit fizik ose kapacitetin shërbyes • Zvogëlimin e kostos operative • Zgjatjen e jetëgjatësisë • Përmirësimin e kualitetit të prodhimit, etj. <p>Mirëmbajtja e rregullt e pasurive nuk konsiderohet përmirësim dhe nuk duhet të kapitalizohet.</p> </div>	1.Zyrtari i pasurisë	Nuk ka	Nuk ka	<p>1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore</p> <p>(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës).</p>
-----	-------------------------	---	----------------------	--------	--------	--

Nën-Procesi:Prezantimi dhe Shpaloja e Pasurive jo-financiare në Pasqyra Vjetore Financiare						
18.	Prezantimi dhe Shpaloja në Pasqyra Vjetore Financiare	<p>18.1. Pas barazimit të gjendjes me inventarizimin dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo-financiare, gjendja e pasurive prezantohet në Pasqyrat Vjetore Financiare.</p> <p>18.2. Zyrtari Kryesor Financiar në fund të vitit, sipas kërkesave të rregullores vjetore për Pasqyrat Vjetore Financiare siguron të dhënat nga Zyrtari i Pasurisë dhe gjendjen e pasurive në Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës.</p> <p>18.3. Prezantimi i pasurive jo-financiare mbi 1,000€ nga regjistri kontabël në SIMFK në vlerën kontabël neto. Pasuria jo-financiare jashtë përdorimit nuk do të prezantohet në pasqyrat vjetore financiare mirëpo vetëm shpaloset.</p>	1.Zyrtari Kryesor Financiar	Deri më 15 janar të vitit vijues	1.Pasqyrat Vjetore Financiare	1. Rregullore Nr. 01/2017 për Raportimin Vjetor nga Organizata Buxhetore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës) .
PJESA II: Procesi i Kontrollit të pasurive jo-financiare kapitale						
Nën-procesi: Tjetërsimi i pasurive						
19.	Shitja e pasurive	<p>19.1. Kryetari i Komunës themelon Komision për Vlerësimin e Pasurisë jo-Financiare.</p> <p>19.2. Komisioni i Vlerësimit të pasurisë bën vlerësimin e pasurive dhe përgatitë raport me të dhënat e pasurive dhe rekomandime për Kryetarin e Komunës.</p>	<p>1.Kryetari i Komunës</p> <p>2.Komisioni i Vlerësimit/Tjetërsimit</p>	Nuk ka	1.Vendim për themelimin e komisionit të vlerësimit për pasuritë që do shiten	1.Rregullore Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore

